

PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
(Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë)

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik (këtej e tutje AP) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. AP-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së AP-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare drtkvlore.com si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e AP-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AP -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: AP-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AP-së dhe përkatësisht: : *Ligji Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe muzetë”, VKM, nr. 425, datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me leccëpër projektim,zbatim,mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore,për kryerjen e investimeve me*

fonde publike në pasuritë kulturore ”, i ndryshuar; Udhëzim nr. 269, datë 11.08.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, i ndryshuar; Ligji nr. 10 296, dt.08.07.2010 “Per menaxhim financiar dhe kontrollin”; Ligji per buxhetin e vitit në vazhdim; Ligji nr. 152/2013; Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, I ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"; Ligji nr. 9154, datë 6. 11. 2003 “Për arkivat”; Ligji Nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 238, datë 18.2.2010, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë";Ligji nr.35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”; Urdheri Nr.139 Datë 21.10.2019 “Për Miratimin e Strukturës dhe te organikes të Drejtorive Rajonale te Trashëgimisë Kulturore”,I ndryshuar.

Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2024-2026, Plani Kombëtar i Integritimit Evropian 2024-2026 ;

1. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
2. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
3. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
4. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Ministria e Kulturës vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit drtkvlore.com dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;

- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- AP-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AP-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

**IV. RREGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE VLORE**

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit
<p>Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.</p> <p>Të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë.</p> <p>Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.</p>	<p>Neni 7/1/a/d</p>	<p>Organigrama</p> <p>Misioni i D.R. T.K.</p> <p>Sektorët</p> <p>Rregullore e Brendshme e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlore e miratuar nga Ministria e Kulturës , me n nr.355,date 02.06. 2023.</p> <p>Struktura e pagave</p> <p>Tabela përmbledhëse e të dhënave për arsimin, kualifikimet dhe pagat e punonjësve .</p> <p>Vendimi I Keshillit të Ministrave nr.173,date 07.03.2003”Për emërimin,lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve,në varësi të Këshillit të Ministrave,Kryeministrit ose Ministrit”,si dhe Ligjit nr.7961,date 12.7.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 4,neni 102 I Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Urdheri Nr.139 Datë 21.10.2019 <i>“Për Miratimin e Strukturës dhe te organikes të Drejtorive Rajonale te Trashëgimisë Kulturore”</i>,I ndryshuar.</p>	<p>1)Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare</p> <p>2)Përditësohet pas çdo akti emërimi</p> <p>3)Menjëherë pas daljes së VKM-së</p>	<p>Në faqen zyrtare të drtkvlore, në menunë “Institucioni”</p> <p>Në rregulloren e në faqen zyrtare të drtkvlore, në menunë “Baza ligjore”</p> <p>Në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, në menunë “Dokumente”</p> <p>Në faqen zyrtare të AP : drtkvlore.com</p>

<p>Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.</p>	<p>Neni 7/1/b</p>	<p>Ligje Vendim i Këshillit të Ministrave Udhëzime</p> <p>Rregullore Licencë Programe</p> <p>Konventa Marrëveshje Protokoll</p> <p>Kalendare të përbashkët</p> <p>Manuale</p>	<p>1)Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare</p> <p>2)Menjëherë pas miratimit nga titullari</p> <p>3)Menjëherë pas nënshkrimit</p> <p>4) Menjëherë pas publikimit</p>	<p>Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë në menunë “Programi”, “Baza ligjore” dhe “Dokumente”</p>
<p>Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.</p>	<p>Neni 7/1/c/g</p>	<p>Ligji nr.119/2014 “për të Drejtën e Informimit”</p> <p>Format kërkesë</p> <p>Format ankese</p> <p>Adresë postare:Lagjia “Hajro Çakëri” Rruga “Sulejman Delvina”, nr.56, Vlorë</p> <p>Orari: E Hënë - E Enjte 08:00 - 16:30 E Premte 08:00 - 14:00</p> <p>Adresë emaili:info@drtkvlore.gov.al</p>	<p>1)Pas miratimit të Programit të transparencës.</p> <p>2)Menjëherë në rast ndryshimesh</p>	<p>Në faqen zyrtare në menunë “Programi i Transparencës”</p>
<p>Të dhëna për vendodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit.</p>	<p>Neni7/1/ç</p>	<p>Adresa:Lagjia “Hajro Çakëri” Rruga “Sulejman Delvina”, nr.56, Vlorë.</p> <p>Orari zyrtar është :</p> <p>E hënë-E enjte 08:00-16:30 E premte 08:00-14:00</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit:</p>	<p>1)Pas miratimit të Programit të Transparencës dhe urdhrimit të caktimit të Koordinatorit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë dhe në menunë “Programi i transparencës”</p>

		<p>Artan Balla</p> <p>E-mail: artan.ball@drtkvlore.gov.al</p> <p>Kontakt: 0333430665</p> <p>0683890325</p>		
<p>Mekanizmat monitorues;</p> <p>raporte auditit;</p> <p>dokumentet me tregues performance</p>	<p>Neni 7/1/dh</p>	<p>Raporte Monitorimi</p> <p>Raporte Auditimi të Brendshëm</p> <p>Raporte Auditimi nga KLSH</p> <p>Kultura 2024-2015 “Shifra dhe Fakte”</p> <p>Programi i Kulturës 2024-2025</p> <p>Programi i Trashëgimisë Kulturore 2024-2025</p> <p>Tregues performance</p> <p>Për masat kundër korrupsionit</p>	<p>1)Menjëherë pas depozitimit në institucion</p> <p>2)Menjëherë publikimit pas</p> <p>3)Nëntor i cdo viti</p>	<p>Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë, në menunë “Dokumente”, menunë “Programe” dhe në menunë “Lajme”</p>
<p>Buxheti</p>	<p>Neni 7/1/e</p>	<p>Buxheti 2024,</p>	<p>1)Pas miratimit të Ligjit për Buxhetin</p>	<p>Në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, në menunë “Baza ligjore”</p>
<p>Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese , të koncensionit /ppp</p>	<p>Neni 7/1/ë</p>	<p>Regjistri i prokurimeve</p>	<p>1)Menjëherë pas dërgimit në APP</p>	<p>Në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës në menunë “Dokumente”</p>

		Ligji “Per prokurimin publik” nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar		
Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standartet për cilësinë e shërbimit	Neni 7/1/f	<p>Publikime lidhur me vende pune</p> <p>Thirrje për projekt propozime</p> <p>AP krijon, administron dhe përditëson regjistrin e të dhënave, të hapur për publikun, dokumentar dhe elektronik, për regjistrimin vullnetar të krijimeve të mbrojtura nga e drejta e autorit;</p> <p>DDA kryen veprimtari profesionale dhe administrative dhe jep asistencë teknike dhe shkencore në lidhje me karakterin origjinal të produkteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, me kërkesë të organeve të hetimit penal dhe me shpenzime të të pandehurve, në qoftë se fajësia e tyre provohet; kryen, me kërkesë dhe kundrejt pagesës, hetim administrativ, në favor të palëve të interesuara.</p>	<p>1)Menjëherë pas daljes së rezultatit</p> <p>2)Menjëherë pas miratimit me Urdhër Ministri</p> <p>3)Në mënyrë periodike</p>	<p>Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë në menunë “Njoftime”</p> <p>Në faqen zyrtare të AP: drtkvlore.com</p>
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” p/akt ligjor dhe nënligjor	<p>1)Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare</p> <p>2)Në momentin kur kërkohen konsultime me publikun</p>	Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë në menunë “Dokumente”
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/1/h	Rregullore e brendshme Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”	1)Pas miratimit të rregullores	Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë në menunë “Dokumente”
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	1)Cdo tre muaj sipas parashikimeve në Ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”	Në faqen zyrtare në menunë “Programi i Transparencës”

<p>Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti public dhe të procedurave për ti përfituar ato</p>	<p>Neni 7/1/j</p>	<p>Thirrje për projekt propozime</p> <p>Pensionet e posacme për persona që kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e artit dhe kulturës</p>	<p>1)Menjëherë pas miratimit me Urdhër Ministri</p>	<p>Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë në menunë “Njoftime”</p>
<p>Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.</p>	<p>Neni 7/1/k</p>	<p>Vendime të miratuara për monumentet e kulturës dhe shpalljen e tyre, për kalimin në përdorim të objekteve të ndryshme, kërkesa për mbështetje financiare dhe informacion se si mund të procedohet për të marrë mbështetje financiare, informacione mbi tendera të zhvilluara nga Ministria e Kulturës, informacione mbi zbatimin e Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe Ligjit nr.116/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik”</p> <p>Kërkesa për rregjistrim, certifikim</p>	<p>1)Pas shpalljes së afatit për aplikim të projekt – propozimeve.</p> <p>2)Menjëherë pas publikimit të Rregjistrimit të përditësuar të Kërkesave dhe Përgjigjeve</p>	<p>Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë në menunë “Njoftime”</p>

Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/1	Informacion me përmbajtje për trashëgiminë kulturore.	Në mënyrë periodike Menjëherë pas caktimit të datës së zhillimit të sesioneve të informimit	Në faqen zyrtare të DRTK-Vlorë në menunë “Njoftime”
-----------------------------------	------------	--	--	---

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AP-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit drtkvlorë.com dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.